



Nr. 6414 / Prot

Tiranë, më 25/5/2021

URDHËR

Nr. 96, Datë 25.5 2021

**“PËR MIRATIMIN E PËRKTHIMIT NË GJUHËN SHQIPE TË NDRYSHIMEVE TË
STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
2. Njësia ekonomike do të zbatojë ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 për periudha vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 janar 2023 ose më pas. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Për SNK 1, nëse njësia ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Për SNK 8, njësia ekonomike do të zbatojë ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe ndryshimet në politikat kontabël që ndodhin në periudhën e parë raportuese vjetore në të cilën zbaton ndryshimet, ose më pas.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

